



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.312/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 02 / 2021

V E N D I M

Nr. 27, Datë 16 / 02 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 159 Regj., datë 29.12.2020, të V. K, kundër Bashkisë Klos, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Klos dhe ka mbajtur detyrën e audituesit të brendshëm, pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm. Ankuesi shprehet se ka konkuruar nëpërmjet procedurave të konkurimit dhe është shpallur fitues me datë 31.03.2017. Me datë 17.05.2019 është emëruar përkohësisht në pozicionin e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm deri në përfundimin e procedurave të konkurimit për shkak të vakancës. Me datë 11.11.2019 ankuesi ka paraqitur kërkesë për miratimin e dorëheqjes nga kjo detyrë. Në vijim, me datë 15.11.2019 Bashkia Klos ka vendosur: “*Të lirojë nga detyra e Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm, në Sektorin e Auditit të Brendshëm Bashkia Klos, V. K sipas kërkesës së tij me nr. 2607 prot., datë 11.11.2019*”.

¹ Referuar vërtetimit nr. 62, datë 07.12.2020 të subjektit politik Parta Demokratike, dega Mat, ankuesi ka provuar bindjet dhe angazhimin e tij politik.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në parashtrimet e tij, subjekti ankues ka pretenduar se ai ka kërkuar dorëheqjen nga detyra e Përgjegjës të Sektorit dhe jo nga ajo e audituesit dhe se Bashkia Klos nuk duhet të kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës me të, por duhet ta kishte kaluar atë në pozicionin e Audituesit të Brendshëm, pozicion të cilin e kishte fituar me konkurim.

Ankuesi e ka kundërshtuar lirimin e tij nga detyra tek Komisioneri për Mbikqyrjen në Shërbimin Civil, i cili nëpërmjet Vendimit nr. 124, datë 15.10.2020 ka vendosur: *“Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të ankesës me nr. 373 prot., datë 29.05.2020 të paraqitur nga punonjësi V. K për parregullsi të pretenduara se janë kryer gjatë lirimit nga detyra e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Klos dhe mos emërimin e tij në pozicionin e punës si Specialist i Auditit të Brendshëm, pasi nuk u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin civil dhe arkivimin e çështjes”*.

Ankuesi ka parashtruar se vendimi i mësipërm është i padrejtë. Ai ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit sepse ndërprerja e marrëdhënieve të punës është e paligjshme dhe ka ndodhur për arsyt poshtëcituar:

- Si punonjës i njësisë së auditimit të brendshëm, marrëdhëniet e punës mund t'i ndërpriten vetëm sipas përcaktimeve të ligjit “Për auditin e brendshëm në Sektorin Publik”, në rastin kur punonjësi nuk çertifikohet brenda periudhës dy vjeçare.
- Nuk ka qenë në listë pritjeje por ka ushtruar detyrën e audituesit prej datës 17.05.2017 dhe në maj të vitit 2018 ka konkuruar dhe është shpallur kandidat fitues nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, si auditues i brendshëm për ndjekjen e procesit të kualifikimit, gjatë sezonit 2018-2019, ku citohet në listën e kandidatëve fitues me nr. rendor 28.
- Ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji “Për auditin e brendshëm në Sektorin Publik” dhe emërimi i tij është bërë konform parashikimeve ligjore të përcaktuara për punonjësit civil nëpërmjet procedurave të konkurimit.

Subjekti ankues shprehet se punëdhënësi, pas kërkesës së tij për dorëheqje nga detyra e Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm, duhet të kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës me të për këtë pozicion dhe duhet ta kishte kaluar në pozicionin e audituesit të brendshëm, pozicion të cilin e kishte fituar me konkurim, për arsyen se në këtë njësi kishte dy vende vakante për auditues.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga ana e punëdhënësit vetëm për shkak të bindjeve të tij politike të ndryshme me ato të titullarit dhe shprehet se, pavarësisht se janë krijuar vende të lira pune për pozicionin që ai ka patur, si auditues i brendshëm, atij nuk i është ofruar asnjë vend pune dhe as nuk është kaluar në listë pritjeje për një periudhë dy vjeçare.

Po ashtu, z. K ka pretenduar se ndaj tij nuk është ndjekur një procedurë e rregullt ligjore dhe i është mohuar e drejta e informimit dhe ankimit nga ana e punëdhënësit dhe se në vend të tij

është emëruar një punonjës tjetër pa procedurë të rregullt konkurimi dhe në kundërshtim me kriteret ligjore të kërkuara për atë pozicion pune.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Klos.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 21/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 98 prot., datë 13.01.2021 Komisioneri ka njoftuar subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa, Bashkinë Klos dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
2. Me shkresën me nr. 104/1 prot, datë 29.01.2021, Bashkia Klos ka sjellë parashtrime dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga ankuesi për diskriminim nga ana e Bashkisë Klos, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor³.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga ankuesi pranë Gjykatës, ndër të tjera, në faqet 6-8 të saj, citohet se: *“Miratimi i dorëheqjes bëhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe jo nga titullari i institucionit në referim të nenit 64 të ligjit. Kështu edhe sikur të ishte plotësuar organika me dy aditues, unë duhet të isha renditur në listën e pritjes për një periudhë 2-vjeçare dhe nëse do të arrinte të rihapte një procedurë konkurimi për aditues, unë duhet të isha rirenditur në listën e fituesve dhe sipas renditjes duhet të ishte bërë emërimi dhe jo të bëhet emërimi nga titullari pa konkurim dhe jashtë kriterëve dhe mua të më ndërpriten marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, duke pasur 2 (dy) vende vakante në njësinë e auditit të brendshëm dhe duke emëruar persona të tjerë pa konkurim dhe jashtë kriterëve, sipas preferencave partiake. Unë jam larguar për të punësuar të tjerët, kështu që jam diskriminuar nga ana e palës së paditur vetëm për shkak të bindjeve politike, megjithëse kam qenë i vetmi punonjës i punësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit dhe i certifikuar në Bashkinë Klos. Unë nuk mund të largohesha nga detyra, pasi mbrohesha nga legjislacioni për statusin e nëpunësit civil dhe ligji “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe ligji “Për auditin e brendshëm”.*

Jam trajtuar në mënyrë të pabarabartë, duke më diskriminuar për shkak të përkatësisë politike”.

Në vijim të kërkesë-padisë së tij, subjekti ankues ka pretenduar para gjykatës se, Bashkia Klos, ka shkelur nenin 5 të ligjit “Për nëpunësit civil”, parimet e administrimit të shërbimit civil, të cilat bazohen në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve politike, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo*

³ Kërkesë padia e ankuesit ka si palë të padituara: Bashkinë Klos dhe Komisionerin për Mbikqyrjen në Shërbimin Civil.

vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadiës. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadiës, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadiës.”

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes“, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 159 Regj., datë 29.12.2020, të V. K dhe deklaron të përfunduar procedurën e shqyrtimit të saj.**

Neni 90/2, i Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka përcaktuar se: “Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji”.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 90, pika 2, të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 159 Regj., datë 29.12.2020, të paraqitur nga V. K, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike

Lloji i vendimit: Deklarim i përfunduar i procedurës administrative